

**GJETJET MBI DHUNËN ME BAZË
GJINORE NË MEDIA DHE RRJETET
SOCIALE GJATË FUSHATËS
ZGJEDHORE TË VITIT 2025**



GJETJET MBI DHUNËN ME BAZË GJINORE NË MEDIA DHE RRJETET SOCIALE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE TË VITIT 2025

Qershor 2025

Mbështetur nga: Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD)

Përgatiti: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Të gjitha të drejtat për këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

Ky raport është hartuar nga Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim" në kuadër të projektit "Korniza e Ballkanit Perëndimor: Investimi në Rezistencën Demokratike" i cili zbatohet nga Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) me mbështetjen financiare nga Ambasada Britanike në Tiranë.

Autorët

Mirela Arqimandriti
Aleksandar Cekov
Natasha Dimova
Esmeralda Hoxha

Tabela e përmbajtjes

SHKURTESA.....	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
HYRJE	8
PËRKUFIZIMI I DHUNËS ME BAZË GJINORE NË POLITIKË	9
METODOLOGJIA E MONITORIMIT TË MEDIAVE NË LIDHJE ME RASTET E DHUNËS NDAJ GRAVE NË POLITIKË	10
BURIMET E TË DHËNAVE	10
LLOJET E MEDIAS SË MONITORUAR	11
KATEGORITË E KODIMIT	11
PROCESI TEKNOLOGJIK DHE ANALITIK	11
MEKANIZMI I PLATFORMËS STOPVAWP	12
KUFIZIMET.....	12
VALIDIMI DHE INTERPRETIMI	12
KONTEKSTI POLITIK DHE LIGJOR	13
PËRMBLEDHJE E DINAMIKAVE MEDIATIKE GJATË ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE TË MAJIT 2025	13
KUOTAT GJINORE DHE STATISTIKAT E PËRFAQËSIMIT	13
MBROJTJA LIGJORE EKZISTUESE DHE ANGAZHIMET POLITIKE PËR BARAZINË GJINORE DHE DHUNËN NDAJ GRAVE NË POLITIKË (NË NIVEL KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR).....	14
ANGAZHIMET NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE.....	15
MEKANIZMAT INSTITUCIONALË DHE ANGAZHIMET POLITIKE	15
MANGËSITË DHE DOBËSITË.....	16
MUNDËSI PËR FORCIMIN E MBROJTJES.....	16
GJETJET NGA MONITORIMI	17
KANDIDATËT DHE POLITIKANET GRA.....	18
KOMENTE ONLINE ME GJUHË URREJTJEJE TË LIDHURA ME DHUNËN ME BAZË GJINORE (DHBGJ)	22
SHEMBUJ TË KOMENTEVE ME GJUHË URREJTJEJE	25
REAGIMET INSTITUCIONALE DHE CIVILE	29
DHBGJ NË PROGRAMET DHE MATERIALET E FUSHATËS SË PARTIVE POLITIKE.....	30
PASOJAT POLITIKE DHE SHOQËRORE	32
RASTE TË RAPORTUARA NË STOPVAWP.AL.....	33
RASTE NGA TASK FORCA – RRJETI “BARAZI NË VENDIMARRJE”	34
MEDIAT DHE PLATFORMAT MË AKTIVE NË PËRHAPJEN E PËRMBAJTJES SË DHUNËS NË BAZË GJINORE	35
LLOJET E NGJARJEVE TË LIDHURA ME DHBGJ-NË: KATEGORIZIMI TEMATIK	36
ARTIKUJ TË LIDHUR ME FUSHATËN ZGJEDHORE.....	36
TENDENCAT TEMATIKE NË ZGJEDHJET 2025	37
PËRFUNDIME: PËRFAQËSIMI I GRAVE - JO VETËM NUMRA, POR DINJITET DHE SIGURI	40
REKOMANDIME PËR TË TRAJTUAR DHUNËN ME BAZË GJINORE NË POLITIKË	41
BIBLIOGRAFI.....	42

SHKURTESA

Shkurtesa	Kuptimi i plotë
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DHBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
DHBGJP	Dhuna me Bazë Gjinore në Politikë
GADC	Gender Alliance for Development Center
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (i Konventës së Stambollit)
IPU	Unioni Ndërparlamentar
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
NDI	National Democratic Institute
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE)
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SDG	Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
SPAK	Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
StopVAWP	Platforma për raportimin e dhunës me bazë gjinore në politikë (nga GADC)

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i Monitorimit të Medias: Dhuna me Bazë Gjinore në Politikë – Shqipëri, Zgjedhjet Parlamentare Maj 2025

Ky raport ofron një analizë mbi dhunën me bazë gjinore në kontekste politike gjatë fushatës për zgjedhjet parlamentare të mbajtura në Shqipëri në periudhën prill–maj 2025, duke u fokusuar në raste konkrete të dhunës ndaj grave në politikë. Përmes një qasjeje të shumëfishtë të monitorimit të medias që përfshin median tradicionale, platformat e rrjeteve sociale dhe mekanizmat e raportimit të drejtpërdrejtë, studimi identifikon tendencat, format dhe reagimet institucionale që lidhen me dhunën ndaj grave në politikë (DhGP).

Raporti i udhëhequr nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (GADC), në bashkëpunim me Pikasa Analytics dhe me mbështetjen e Fondacionit Westminster për Demokraci, synoi të evidentojë format, intensitetin dhe ndikimin e dhunës politike me bazë gjinore në media tradicionale dhe rrjetet sociale.

Gjetjet tregojnë se gratë kandidate, politikanet, gazetaret dhe aktivistet janë objekt i gjuhës së urrejtjes, seksizmit, stereotipeve, delegjitimitimit dhe sulmeve të koordinuara që shpesh përfshijnë edhe përmbajtje të dhunshme dhe seksuale. Këto forma dhune minojnë barazinë reale gjinore në jetën publike dhe pengojnë pjesëmarrjen e grave në politikë si aktore të barabarta dhe të sigurta.

Platforma “StopVAWP” dhe mjetet teknologjike të përdorura për këtë monitorim ofruan një evidencë të qëndrueshme dhe të matshme të rasteve të dhunës ndaj grave në politikë në Shqipëri, duke forcuar qasjen ndaj raportimit të dhunës në mënyrë të verifikueshme dhe të aksesueshme.

Ndërkohë, raporti thekson mungesën e mekanizmave të institucionalizuar për mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj kësaj dhune, si dhe boshllëqet ligjore dhe administrative në mbikëqyrjen e zbatimit të kuotave gjinore dhe rregullave për përfaqësim të drejtë. Raporti gjithashtu identifikon se prania e kuotave gjinore në listat zgjedhore nuk është e mjaftueshme për të garantuar përfaqësim cilësor dhe të sigurt të grave në politikë. Mungesa e mbrojtjes institucionale dhe e përgjegjshmërisë së aktorëve politikë dhe institucionalë ndikon negativisht në klimën demokratike dhe e zhvesh pjesëmarrjen e grave nga dinjiteti dhe ndikimi politik real.

Gjetjet Kryesore:

- Dhuna me bazë gjinore në politikë mbetet një fenomen **i përhapur** dhe shpesh **i normalizuar** si në hapësirat fizike ashtu edhe në ato digjitale. Pavarësisht rritjes së dukshmërisë, shumë raste mbeten të paraportuara për shkak të frikës, stigmës dhe mungesës së reagimit institucional.
- Platformat mediatike ndihmuan në rritjen e dukshmërisë së rasteve të dhunës me bazë gjinore në politikë dhe mbulimi nuk ishte gjithmonë etik apo i ndjeshëm gjinor. Narrativa seksiste, turpërimi në lidhje me trupin dhe nën-përfaqësimi i kandidateve gra ishin të zakonshme.

- Partitë politike në përgjithësi nuk treguan një angazhim domethënës ndaj çështjeve të dhunës me bazë gjinore gjatë fushatave. Kandidatet gra përjetuan përjashtim simbolik, sulme verbale dhe ngacmime digjitale, shpesh pa mbrojtje institucionale ose mbështetje nga partitë e tyre.
- Institucione si Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe organet kundër diskriminimit shfaqën reagime të dobëta ose të vonuara ndaj incidenteve të dhunës me bazë gjinore në politikë, duke u mbështetur kryesisht në organizatat e grave të cilat monitoruan dhe denoncuan rastet e dhunës me bazë gjinore në politikë gjatë fushatës zgjedhore 2025.
- Dezinformimi i gjeneruar nga inteligjenca artificiale dhe sulmet dixhitale kishin si shënjestër të veçantë gratë, duke forcuar mjedise armiqësore digjitale dhe duke minuar pjesëmarrjen e tyre në jetën publike.

Raporti përfshin disa rekomandime kryesore të përmendura më poshtë:

- **Forcimin e kornizës ligjore dhe institucionale**, përfshirë njohjen e DHBGJP si një formë e veçantë dhune dhe integrimin e saj në ligjin për barazinë gjinore dhe Kodin Zgjedhor.
- **Krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm institucional** për raportimin, ndjekjen dhe sanksionimin e rasteve të DHBGJP.
- **Angazhimin e mediave dhe autoriteteve rregullatore** (si AMA) për të vendosur standarde të qarta për mbulimin gjinor të fushatave dhe për të ndëshkuar gjuhën e urrejtjes.
- **Ndërtimin e një aleance të aktorëve institucionalë dhe të shoqërisë civile**, për të siguruar që raportimi i dhunës ndaj grave në politikë të mos mbetet i izoluar por të kthehet në pjesë të strukturave të qëndrueshme shtetërore.
- **Zhvillimin e fushatave publike ndërgjegjëse** që de-stigmatizojnë gratë në politikë dhe promovojnë pjesëmarrjen e tyre si të barabartë dhe të sigurt.

Në përfundim, raporti bën thirrje për një **qasje të re politike dhe institucionale** ndaj pjesëmarrjes së grave në jetën publike. Pa siguri, pjesëmarrja është thjesht ekspozim – jo fuqizim. Përfaqësimi pa mbrojtje nuk është demokraci e plotë.

HYRJE

Zgjedhjet Parlamentare të Shqipërisë 2025 u zhvilluan në një kontekst të komunikimit politik gjithnjë e më të dixhitalizuar, polarizimit të thelluar dhe boshllëqeve të vazhdueshme gjinore në përfaqësimin politik mediatik. Mediat tradicionale dhe rrjetet sociale luajnë një rol kritik në formësimin e opinionit publik, ndikimin në narrativat politike dhe përcaktimin e dukshmërisë së partive dhe kandidatëve. Megjithatë, këto platforma shërbejnë gjithashtu si mjedise ku përhapen dhuna me bazë gjinore, dezinformimi dhe gjuha e urrejtjes. Për të siguruar një proces zgjedhor të informuar, gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm, ishte e nevojshme të analizoheshin:

- Dinamikat e përmbajtjes mediatike dhe në rrjetet sociale që lidhen me zgjedhjet,
- Përfaqësimi i aktorëve politikë,
- Temat dhe narrativat dominuese në diskursin publik,
- Dukshmëria e grave në politikë dhe mënyra si trajtohen temat që lidhen me dhunën me bazë gjinore në media dhe rrjetet sociale.

Angazhimi i GADC për të raportuar sulmet mediatike, kryesisht ndaj grave në politikë gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2025, buron nga një punë disa-vjeçare e vazhdueshme mbi këtë çështje. Në vitin 2022, GADC me mbështetjen e WFD ndërtoi platformën online <https://stopvawp.al/>, si një mekanizëm për të raportuar dhe dokumentuar rastet e dhunës me bazë gjinore në politikë. Megjithë promovimin e saj në media dhe rrjete sociale, platforma nuk regjistroi asnjë rast të raportuar, çka ngre shqetësimin e thellë se, edhe pse dhuna ishte e dukshme dhe e dokumentueshme, gratë në politikë hezitonin të denonconin përjetimet e tyre. Kjo mungesë raportimi ishte sinjal alarmi për GADC-në, e cila vendosi të ndërmarrë një nismë më të strukturuar: hartimin e këtij raporti analitik dhe zhvillimin e metodologjive të monitorimit digjital për të identifikuar dhe evidentuar raste konkrete të dhunës. Pikërisht këto raste, të dokumentuara përmes monitorimit të medias dhe rrjeteve sociale, paraqiten më poshtë si dëshmi e sfidave reale që gratë përballen në hapësirën publike dhe politike.

Monitorimi dhe raporti mbulojnë periudhën nga 1 prilli deri më 31 maj 2025.

Raporti synon të analizojë në çfarë mase DhBGjP u shfaq si një çështje politike dhe shqetësim publik gjatë periudhës zgjedhore, përfshirë praninë e saj në platformat politike, retorikën e fushatës, narrativat mediatike dhe diskursin online. Raporti do të ofrojë njohuri të mbështetura në prova mbi mënyrën se si aktorët politikë dhe institucionet reagues ndaj DhBGj, si u portretizuan viktimat dhe aktivistet për të drejtat e grave, si dhe nëse mbulimi mediatik respektoi standardet etike dhe të orientuara drejt viktimës.

Përkufizimi i dhunës me bazë gjinore në politikë

Dhuna me bazë gjinore në politikë (DhBGjP)¹ i referohet çdo akti dhune apo kërcënimi me dhunë, të drejtuar ndaj individëve bazuar në gjininë, shprehjen gjinore apo orientimin seksual të tyre, me qëllimin ose efektin për t'i përjashtuar nga pjesëmarrja politike, për të penguar të drejtën e shprehjes së tyre apo për të minuar autoritetin dhe besueshmërinë e tyre në jetën publike.

Kjo formë dhune prek në mënyrë disproporcionale gratë, personat jo-binarë dhe individët LGBTQI+ dhe shpeshherë normalizohet ose minimizohet brenda diskursit politik. Ajo mund të vijë nga kundërshtarët politikë, kolegët brenda partisë, aktorët mediatikë ose publiku dhe shfaqet në forma të ndryshme si më poshtë:

Dhuna Verbale

- Përdorimi i gjuhës seksiste, fyese ose kërcënuese në fjalime, intervista, debate apo forume publike.
- Talljet ose diskreditimi i aftësive apo kualifikimeve të grave bazuar në gjininë e tyre.
- Turpërimi publik, intimidimi apo poshtërimi përmes fyerjeve me kontekst seksist apo me ngarkesë gjinore.

Dhuna Online/Digjitale

- Fushata të organizuara ngacmimi në rrjetet sociale (p.sh. sulme masive, publikim i të dhënave personale – *doxing* (*Doxing*)², përdorimi i *deepfake*³).
- Kërcënime me dhunë seksuale ose fizike në komente, mesazhe apo llogari të rreme.
- Imazhe të manipuluar apo përhapje dezinformimi që dëmton reputacionin e kandidatëve gra.
- Kërcënime ndaj fëmijëve.

Dhuna Simbolike

- Fshirja ose marginalizimi i pranisë së grave në materialet e fushatës apo në ngjarjet publike.
- Paraqitja e grave kryesisht në role emocionale, familjare ose estetike dhe jo si lidere apo eksperte.
- Përdorimi i mjediseve dhe imazheve të dominuara nga meshkuj për të transmetuar autoritet.

¹ Sipas European Commission: "Dhuna me bazë gjinore është dhuna e drejtuar kundër një **personi** për shkak të gjinisë së atij personi ose dhuna që prek personat e një gjinie të caktuar në mënyrë disproporcionale." pra mund të themi që pjesë mund të jenë dhe burrat. Ndoshta termi që duhet të përdorim është Gender Based Violence Against Women duke qenë se kjo është ajo që po analizojmë.

² Amnesty International. 2020. Troll Patrol Findings: Using Crowdsourcing, Data Science & Machine Learning to Measure Online Abuse Against Women. Online: <https://www.amnesty.org>. Përcaktim i përdorur nga Amnesty International për Doxing- Akt i publikimit të informacionit personal më parë privat për një individ, pa pëlqimin e tij/saj, shpesh me qëllim keqdashës – si për ta frikësuar, ngacmuar apo kërcënuar.

³ Merriam-Webster Dictionary. (n.d.). Deepfake. Marrë nga <https://www.merriam-webster.com/dictionary/deepfake>. Deepfake është një pamje ose regjistrim që është ndryshuar dhe manipuluar në mënyrë bindëse për të paraqitur dikë si duke bërë apo thënë diçka që në të vërtetë nuk e ka bërë apo thënë.

Ky përkufizim thekson qëllimin mashtrues të deepfake, duke përdorur inteligjencën artificiale për të krijuar materiale të rreme, por shumë realiste.

Dhuna Fizike ose Seksuale

- Kërcënime apo sulme fizike të mirëfillta gjatë aktiviteteve elektorale ose paraqitjeve publike.
- Cënimi i privatësisë ose ndjekja e qëllimshme për qëllime frikësimi.
- Ngacmim seksual ose sulm seksual në mbledhje politike, angazhime mediatike apo brenda strukturave partiake.

Këto veprime synojnë të frikësojnë, të heshtin, të delegjitojnë ose të përjashtojnë gratë dhe pakicat gjinore nga sfera politike, duke minuar drejtpërdrejt pjesëmarrjen demokratike dhe barazinë.

Metodologjia e Monitorimit të Mediave në lidhje me Rastet e Dhunës ndaj Grave në Politikë

Ky raport ndjek një metodologji gjithëpërfshirëse dhe hibride të monitorimit të medias, me synimin për të kapur dhe analizuar dhunën me bazë gjinore në diskursin politik gjatë periudhës së zgjedhjeve parlamentare të prill–maj 2025 në Shqipëri. Metodologjia ndërthur analizën digjitale në kohë reale nga Pikasa Analytics, monitorimin pjesëmarrës përmes platformës www.stopvawp.al të koordinuar nga GADC, si dhe vlerësime cilësore nga aktorë të shoqërisë civile dhe ekspertë të fushës.

Qasja e monitorimit kombinon metodologji si sasiore ashtu edhe cilësore, për të zbuluar, kategorizuar dhe interpretuar incidentet e dhunës ndaj grave në politikë DhGP, si në median tradicionale ashtu edhe në median digjitale. Korniza metodologjike është ndërtuar mbi udhëzime ndërkombëtare mbi etikën e medias, barazinë gjinore dhe sigurinë në mjedisin digjital si dhe është në përputhje me angazhimet e Shqipërisë sipas Konventës së Stambollit⁴, CEDAW⁵ dhe Strategjisë së Barazisë Gjinore të BE-së⁶.

Burimet e të Dhënave

Të dhënat janë mbledhur nga një gamë e gjerë burimesh për të siguruar mbulim gjithëpërfshirës të fenomenit:

- Pikasa Analytics: Përpunoi dhe analizoi përmbajtjen e mbi 90 portaleve informative shqiptare online, duke përfshirë mbi 4,000 artikuj të botuar nga portalet e lajmeve online (mediat digjiitale) dhe monitorim ditor të mijëra faqeve dhe profileve në Facebook, videove në TikTok, llogarive në Instagram dhe kanaleve në YouTube.
- Platforma e raportimit e GADC www.stopvawp.al për herë të parë, mundësoi paraqitjen e dy rasteve të drejtpërdrejta të dhunës ndaj grave në politikë gjatë fushatës, duke ofruar njohuri cilësore unike mbi format e padëklaruar apo të padukshme të DhGP.

⁴ <https://rm.coe.int/168064d3f6>

⁵ <https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/>

⁶ https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-equality-strategy_en

- Të dhëna nga institucione të pavarura dhe nga Task Forca për gratë në politikë e udhëhequr nga Rrjeti “Barazi në Vendimarrje.”
- Vëzhgim Manual i Medias: Monitorim i vazhdueshëm i mediave audiovizive dhe të shkruara, për të identifikuar incidente specifike në kontekst, tonalitetin dhe kornizimin e tyre.

Llojet e Medias së Monitoruar

Gjatë periudhës 1 prill–31maj 2025, janë monitoruar intensivisht mediat online dhe rrjetet sociale për të analizuar mënyrën se si trajtohet dhuna ndaj vajzave dhe grave në politikë në diskursin publik.

Kapaciteti i Monitorimit:

- 90+ media online shqiptare me portale aktive dhe gjithsej 100+ burime digjitale (përfshirë blogje dhe platforma) u monitoruan rregullisht.
 - 3,874 artikuj në ditë u publikuan nga këto burime.
 - Këta artikuj gjeneruan rreth 2.1 milion ndërveprime ditore (komente, shpërndarje, pëlqime).
- 3,562 kanale në rrjetet sociale (Facebook, TikTok, YouTube, Instagram, LinkedIn dhe X/Twitter) u përfshinë në monitorim.
 - Në këto kanale u publikuan rreth 11,000 postime në ditë.:
- Monitorim dhe analizë e vazhdueshme të përmbajtjes në Facebook, TikTok, YouTube, Instagram dhe X (ish Twitter).

Kategoritë e Kodimit

Incidentet e dhunës me DhGP janë koduar duke përdorur një kornizë të strukturuar që përfshin elementet e mëposhtme:

- Lloji i dhunës: verbale, online/digjitale, simbolike, fizike/seksuale
- Shënjestra të dhunës: candidate, gazetare, aktiviste, figurë publike
- Gjinia e autorit dhe viktimës
- Platforma dhe shtrirja: fjalim publik, media, postim viral, etj.
- Shkalla e ashpërsisë: nga komente fyese të lehta deri te kërcënimet e drejtpërdrejta
- Frekuenca dhe përsëritja: nëse është rast i izoluar apo pjesë e një modeli të përsëritur
- Reagimi: dënim publik, heshtje, mbështetje ose veprim ligjor

Procesi Teknologjik dhe Analitik

- **Analiza e automatizuar e përmbajtjes:** Pikasa përdori klasifikues të bazuar në inteligjencë artificiale dhe algoritme, të trajnuar për të identifikuar narrativa politike që përmbajnë ngacmim gjinor, gjuhë diskriminuese, praktika përjashtuese ose dhunë simbolike.

- **Filtrim përmes fjalëve kyçe dhe sentimentit:** Sistemi filtoi përmbajtjen duke përdorur një leksik të gjuhës së urrejtjes me bazë gjinore dhe një ontologji të etiketimit politik, të përshtatura posaçërisht për gjuhën shqipe dhe kontekstin politik të Shqipërisë.
- **Zbulimi i anomalive dhe analiza e trendeve:** Analistët interpretuan rritjet e ndjeshme të përmbajtjes së dëmshme nëpërmjet analizës së narrativave dhe kontekstit politik, duke krahasuar dhe vërtetuar të dhënat e gjeneruara nga algoritmet.
- **Verifikim manual:** Çdo përmbajtje e sinjalizuar i nënshtrohej një verifikimi të dytë nga ekipi kërkimor i Pikasës për të vlerësuar rëndësinë kontekstuale, tonalitetin dhe mundësinë e manipulimit politik.

Mekanizmi i Platformës Stopvawp

Platforma www.stopvawp.al e zhvilluar nga GADC mundësoi:

- Raportim anonim dhe të sigurt përmes një formulari online.
- Monitorim përmes linjës telefonike falas (0800 18 18) për raportime me zë (edhe pse gjatë këtij cikli nuk u mor asnjë rast përmes telefonit).
- Klasifikim i rasteve në kategori të ndryshme (verbale, simbolike, digjitale, institucionale) bazuar në një qasje feministe dhe të përqendruar te viktimat.
- Verifikim të mëtejshëm nga stafi i GADC-së në koordinim me partitë politike apo institucione të pavarura, kur ishte e nevojshme.

Integriteti i të dhënave dhe Etika

- Të gjitha të dhënat janë mbledhur në përputhje me parimet e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR).
- Përmbajtja mediatike është vlerësuar sipas kriterëve të standardizuara për ndjeshmëri gjinore, dinjitetin e viktimës dhe neutralitetin politik.

Kufizimet

- Disa incidente të ndodhura jashtë linje ose në zona rurale mund të kenë mbetur të paraportuara për shkak të mungesës së aksesit apo njohurive digjitale.
- Algoritmet e bazuara në inteligjencë artificiale mund të mos arrijnë të identifikojnë dhunën gjinore të tërthortë apo të koduar që nuk përmban fjalëkyçe të drejtpërdrejta të gjuhës së urrejtjes.
- Reagimet institucionale ishin të vështira për t'u verifikuar për shkak të mungesës së dokumentacionit publik apo mekanizmave të qartësuar të llogaridhënies.

Validimi dhe interpretimi

- Të gjitha rezultatet analitike u validuan nga analistët e GADC dhe Pikasës, të cilët ndërthurën njohuritë e automatizuara me ekspertizën njerëzore për të siguruar saktësi kontekstuale.
- Analistët ofruan vlerësime cilësore për të interpretuar rritjet apo anomalitë domethënëse në prirjet e të dhënave, duke verifikuar gjetjet e gjeneruara nga algoritmet përmes analizës së kontekstit dhe narrativës.

KONTEKSTI POLITIK DHE LIGJOR

Përmbledhje e dinamikave mediatike gjatë Zgjedhjeve Parlamentare të Majit 2025

Zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025 në Shqipëri u zhvilluan në një mjedis mediatik tejet të polarizuar dhe dinamik. Cikli mediatik nxori në pah dy narrativa paralele: njëra që theksonte arritjet e qeverisë dhe aspiratat për integrimin në BE dhe tjetra që fokusohet në parregullsitë zgjedhore dhe korrupsionin sistematik.

Sipas monitorimit të kryer nga Pikasa, angazhimi i publikut në media arriti kulmin mes datave 28 prill dhe 11 maj, duke reflektuar një interes të lartë shoqëror për zhvillimet e fushatës dhe akuzat për manipulime zgjedhore. Platformat tradicionale si Syri.net udhëhoqën për nga vëllimi i përmbajtjes dhe ndërveprimi publik, shpesh duke përforcuar narrativa mbi mashtrime zgjedhore, blerje votash dhe dështime institucionale. Në kontrast, Euronews, Top Channel dhe Vizion Plus gjeneruan ndërveprim të lartë për artikull me përmbajtje më të orientuar drejt politikave dhe mesazhe optimiste ekonomike të lidhura me procesin e integritetit evropian. TikTok, ndërkohë, u konfirmua si platforma më angazhuese, veçanërisht tek votuesit e rinj.

Çështje të tilla si **korupsioni, hetimet e SPAK dhe besueshmëria e KQZ-së** dolën në pah si tematika kryesore, ndërsa çështjet socio-ekonomike si **pensionet dhe paga minimale** u trajtuan me përmbajtje të synuar, duke gjeneruar gjithashtu ndërveprime të konsiderueshme. Në rrjetet sociale, temat si **SPAK dhe korupsioni** prodhuan angazhim të madh, ndërsa **TikTok**, pavarësisht ndalimit zyrtar, rezultoi të ishte platforma më efektive për ndërveprim me përdoruesit.

Aktorë politikë të rinj si Agron Shehaj dhe Arlind Qori shfrytëzuan platformat digjitale për të amplifikuar narrativa reformiste, duke sugjeruar një hapësirë në zgjerim për alternativa ndaj dyshes tradicionale PS–PD. Megjithatë, zgjedhjet ekspozuan gjithashtu një klimë toksike digjitale: gjuha e urrejtjes njohu rritje të ndjeshme, sidomos kundër figurave të njohura politike dhe grave në poste të larta.

Gjuha e urrejtjes u shfaq si një element shqetësues i hapësirës digjitale, duke zbuluar tensionet e thella të klimës së polarizuar politike në Shqipëri. Në përgjithësi, peizazhi mediatik lajti një rol qendror në përcaktimin e sfidave të zgjedhjeve, ku media tradicionale dhe ajo online shërbyen si arena përplasjesh dhe mjete ndikimi.

Kuotat gjinore dhe statistikat e përfaqësimit

Shqipëria ka institucionalizuar në mënyrë progresive **kuotat gjinore** për të nxitur përfaqësimin politik të grave, në përputhje me angazhimet e saj kushtetuese, ligjore dhe ndërkombëtare, përfshirë:

1. Ligji Nr. 9970/2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”
2. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, ndryshuar në vitin 2020 (Ligji Nr. 101/2020)
3. Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
4. Konventa e Stambollit e Këshillit të Europës.
5. Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm Nr. 5 – Barazia Gjinore.

Përmbajtjet kryesore të kuotave përfshijnë:

- Neni 67 i Kodit Zgjedhor: Kërkon që të paktën 30% e kandidatëve në listat e partive për zgjedhjet parlamentare të jenë të gjinisë më pak të përfaqësuar.
- Një ndryshim në vitin 2020 e rriti këtë përqindje në 50%, duke vendosur një sistem alternimi gjinor në lista (i njohur si sistemi "zinxhir").
- Mosrespektimi i kuotave çon në refuzimin e listave të kandidatëve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).
- Në korrik 2024⁷, Parlamenti i Shqipërisë miratoi një paketë amendamentesh në Kodin Zgjedhor. Ndryshimet vendosën një sistem të përzier listash: 1/3 e listës së kandidatëve është e mbyllur, e vendosur nga drejtuesit e partive dhe pa votë preferenciale, ndërsa 2/3 janë të hapura, me mundësinë e votës individuale preferenciale për kandidatët. Këto amendamente futën gjithashtu një kuotë gjinore, sipas së cilës të paktën një në tre kandidatë (30%) në secilën listë të mbyllur dhe të hapur duhet të jetë i gjinisë më pak të përfaqësuar.

Mbrojtja ligjore ekzistuese dhe angazhimet politike për barazinë gjinore dhe dhunën ndaj grave në politikë (në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar)

Shqipëria ka bërë përpertime të rëndësishme në përputhjen e legjislacionit të saj kombëtar me standardet ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe eliminimin e dhunës ndaj grave në jetën politike dhe publike. Megjithatë ka përpitim, ende mbeten boshllëqe në zbatimin efektiv të ligjeve, në llogaridhënien politike dhe në mekanizmat mbrojtës për gratë që përballen me dhunë në hapësirën politike.

Korniza Ligjore Kombëtare:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: Neni 18 garanton barazinë përpara ligjit dhe ndalon çdo formë diskriminimi, përfshirë diskriminimin gjinor; Neni 45 garanton të drejtën e votës dhe pjesëmarrjes së barabartë në çështjet publike.

Ligji Nr. 9970/2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”; a) Sanksionon të drejtën për pjesëmarrje të barabartë në të gjitha fushat e jetës publike; b) Ngarkon institucionet publike me detyrimin për të promovuar përfaqësim të balancuar në organet vendimmarrëse; c) Parashikon integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha politikat publike.

Ligji Nr. 9669/2006 “Për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” (i ndryshuar); a) Fillimisht i fokusuar në mjedisin familjar, ky ligj është pjesë e kornizës më të gjerë për luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe përcakton detyrime institucionale për mbrojtjen e viktimave.

Kodi Zgjedhor (i ndryshuar me Ligjin Nr. 101/2020): a) Prezanton mekanizma detyrues për kuotat gjinore në listat e kandidatëve (50% me sistem alternimi gjinor – “zinxhir”; b) I jep fuqi

⁷ Amendamentet e miratuara më 26 korrik 2024 (Ligji nr. 81/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor”)

ligjore KQZ-së për të refuzuar listat që nuk respektojnë kuotat gjinore; c) Parashikon baza ligjore për të adresuar diskriminimin e tërthortë në përzgjedhjen e kandidatëve.

Kodi Penal i Shqipërisë: a) Penalizon gjuhën e urrejtjes, kërcënimet dhe dhunën, përfshirë ato të drejtuara ndaj individëve për shkak të gjinisë apo funksionit publik; b) Megjithatë, ende nuk e njeh apo kriminalizon dhunën ndaj grave në politikë si një vepër penale specifike, duke lënë të paprekura shumë forma si ngacmimi online apo dhuna simbolike, të cilat janë të zakonshme në kontekste politike.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030; a) Përfshin objektiva të posaçme për rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore; b) Kërkon zhvillimin e politikave për mbrojtjen e grave në politikë dhe jetën publike.

Angazhimet Ndërkombëtare dhe Rajonale

Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Shqipëria e ratifikoi në vitin 1993. Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 23 i CEDAW kërkon heqjen e barrierave për pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe publike. Komiteti CEDAW ka rekomanduar vazhdimisht që Shqipëria të përmirësojë mbrojtjen e grave në politikë kundër ngacmimit dhe intimidimit.

Konventa e Stambollit e Këshillit të Europës (ratifikuar në 2013). Njeh çdo formë dhune ndaj grave si shkelje të të drejtave të njeriut. Neni 4 kërkon mbrojtje kundër dhunës në çdo kontekst, përfshirë jetën publike. Raportet e GREVIO mbi Shqipërinë kanë theksuar nevojën për masa të posaçme kundër dhunës politike dhe mediatike ndaj grave.

Platforma e Pekinit për Veprim (1995). Kërkon pjesëmarrje të barabartë gjinore në politikë dhe eliminimin e përfaqësimeve stereotipike në media. Shqipëria e ka rikonfirmuar angazhimin përmes raportimeve periodike.

Qëllimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm Nr. 5 (SDG5) – Barazia Gjinore. Nën-objektivi 5.5: Garanton pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të grave në jetën politike dhe publike, në të gjitha nivelet e vendimmarrjes.

Udhëzimet e OSBE-së dhe ODIHR-it për Pjesëmarrjen Politike të Grave. Shqipëria, si shtet pjesëmarrës i OSBE-së, ka miratuar angazhime për pjesëmarrje të barabartë dhe krijimin e mjediseve të sigurta zgjedhore për gratë. Vëzhguesit e zgjedhjeve të vitit 2025 ritheksuan nevojën për të adresuar dhunën ndaj kandidateve dhe gazetarëve në diskursin politik.

Mekanizmat Institucionalë dhe Angazhimet Politike

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) - Udhëheq përpjekjet kombëtare për zbatimin e strategjive për barazinë gjinore dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për të mbijetuarat e dhunës.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi - Monitoron diskriminimin me bazë gjinore në sferën publike, përfshirë partitë politike, fushatat zgjedhore dhe median.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale - garanton mbrojtjen e të dhënave personale të individëve, monitoron zbatimin e ligjit përkatës, trajton ankesat, kryen inspekte dhe rrit ndërgjegjësimin publik për privatësinë dhe sigurinë e të dhënave.

Institucioni i Avokatit të Popullit - organ i pavarur kushtetues që ka për detyrë të mbrojtë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara nga Kushtetuta, ligjet dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.

Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore është një strukturë ndërinstitucionale e ngritur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që funksionon si mekanizëm koordinues për politikat e barazisë gjinore në nivel kombëtar. Ky këshill është një pikë kyçe për **ndërtimin e bashkëpunimit ndërsektorial**, për të forcuar mekanizmat institucionalë dhe për të ndjekur angazhimet ndërkombëtare që Shqipëria ka marrë për barazinë gjinore dhe eliminimin e dhunës ndaj grave në jetën politike.

Mangësitë dhe Dobësitë

Megjithëse Shqipëria ka miratuar një kuadër të gjerë ligjor për barazinë gjinore dhe ka ratifikuar instrumente ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të grave, zbatimimi i tyre në praktikë mbetet i pjesshëm, jo i qëndrueshëm dhe shpesh fragmentar.

- **Mungesa e një legjislacioni specifik për DhBGjP:** Aktualisht, nuk ekziston një dispozitë ligjore që e njeh apo e penalizon qartë dhunën ndaj grave në politikë si një formë e veçantë dhune me bazë gjinore. Kjo krijon boshllëqe serioze në adresimin dhe ndëshkimin e rasteve të tilla.
- **Mbrojtje e pamjaftueshme për dhunën digjitale:** Korniza ligjore është e kufizuar për sa i përket trajtimit të formave të reja të dhunës, si ngacmimi online, fushatat e organizuara të dezinformimit dhe sulmet seksiste në rrjete sociale, të cilat targetojnë veçanërisht gratë në politikë dhe në hapësirën publike.
- **Institucione reaguese, jo parandaluese:** Strukturat përgjegjëse shpesh veprojnë vetëm pas ndodhjes së rasteve dhe nuk kanë mekanizma efektivë për të parandaluar dhunën apo për të ndëshkuar aktorët, përfshirë partitë politike që e nxisin ose e tolerojnë këtë sjellje.
- **Mungesa e mekanizmave të posaçëm për raportim dhe mbrojtje:** Nuk ekzistojnë struktura të dedikuara për raportimin, mbështetjen dhe mbrojtjen e grave që përballen me dhunë në kuadër të rolit të tyre politik apo publik. Mekanizmat ekzistues nuk janë të përshtatur për kontekstin dhe specifikat e DhBGjP.

Mundësi për Forcimin e Mbrojtjes

Pavarësisht përparimeve në nivel normativ dhe angazhimeve ndërkombëtare, Shqipëria ka ende një hapësirë të konsiderueshme për të përmirësuar mbrojtjen e grave në politikë nga dhuna me bazë gjinore. Një nga hapat kyç është miratimi i një përkufizimi ligjor të posaçëm për Dhunën ndaj Grave në Politikë (DhGP) dhe përfshirja e saj si vepër penale në legjislacionin

shqiptar, në përputhje me udhëzimet e CEDAW⁸ dhe Unionit Ndërparlamentar (IPU).⁹ Një përkufizim i qartë dhe i zbatueshëm ligjërisht do të mundësonte jo vetëm ndëshkimin e autorëve, por edhe njohjen institucionale të realitetit të dhunës strukturore që përballin gratë në jetën publike.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe strukturat përkatëse brenda partive politike duhet të fuqizohen më tej për të luajtur një rol proaktiv në monitorimin dhe ndëshkimin e gjuhës seksiste dhe të dhunshme, që shpesh normalizohet gjatë fushatave apo në diskursin publik. Kjo do të kërkonte jo vetëm ndërhyrje përmes rregulloreve të qarta administrative, por edhe gatishmëri politike për të vendosur standarde të reja etike në jetën institucionale dhe zgjedhore.

Paralelisht, është thelbësor trajnimi i vazhdueshëm për gjyqtarët, gazetarët dhe stafin politik, me qëllim rritjen e aftësisë për të identifikuar dhe adresuar format e dhunës me bazë gjinore në kontekste politike. Shumë forma të dhunës simbolike apo të tërthortë mbeten të padukshme dhe të paadresuara, pikërisht për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit profesional dhe institucional mbi natyrën e tyre diskriminuese.

Në fund **të kësaj pjese, mund të themi se** për të garantuar një reagim të koordinuar dhe efektiv, kërkohet forcimi i bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile, autoriteteve rregullatore të medias dhe organeve ligjzbatuese. Vetëm përmes një qasjeje të integruar dhe gjithëpërfshirëse mund të parandalohet dhe të ndëshkohet dhuna politike ndaj grave, të sigurohet mbrojtje për viktimat dhe të ndërtohet një kulturë politike gjithëpërfshirëse dhe e barabartë për të gjitha gratë dhe vajzat që zgjedhin të jenë aktive në jetën publike.

GJETJET NGA MONITORIMI

Ky seksion paraqet gjetjet kryesore nga monitorimi i zhvillimeve gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2025, duke përfshirë konstatimet e aktorëve ndërkombëtarë mbi klimën politike dhe mjedisin mediatik.. Raporti paraprak i OSBE/ODIHR theksoi se zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 ishin konkurruese dhe u zhvilluan në mënyrë profesionale, por u mbajtën në një mjedis tejet të polarizuar, ku garuesit nuk gëzuan mundësi të barabarta. Pavarësisht se, kandidatët në përgjithësi patën mundësinë të bëjnë fushatë lirshëm, disa raportuan se u përballën me intimidim.¹⁰ Në këtë kontekst, dhuna me bazë gjinore në politikë (DhBGjP) u shfaq si një model i vazhdueshëm dhe shqetësues, që preku në mënyrë disproporcionale kandidatet gra, aktivistet dhe gazetaret.

Ky seksion paraqet gjetjet kryesore të një procesi gjithëpërfshirës të monitorimit të medias, të zhvilluar gjatë periudhës zgjedhore prill–maj 2025, me qëllim dokumentimin e mënyrës se si dhuna gjinore u shfaq në sferën politike, si në nivel online, ashtu edhe offline.

⁸ "Komiteti CEDAW i OKB-së, përmes Rekomandimit të Përgjithshëm Nr. 35 (2017) dhe Rekomandimit Nr. 23, nënvizon se: Dhuna ndaj grave në jetën publike dhe politike përbën një shkelje të të drejtave të njeriut dhe kërkon veprime të menjëhershme ligjore dhe institucionale për ta parandaluar dhe ndëshkuar.

⁹ IPU, në raportin e tij historik "Sexism, harassment and violence against women parliamentarians" (2016), e përkufizon DhGP si: "Akte dhune me bazë gjinore – fizike, seksuale, psikologjike apo simbolike – të drejtura kundër grave në politikë me qëllim përjashtimin e tyre, heshtjen ose minimin e autoritetit dhe besueshmërisë së tyre.

¹⁰ Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve Shqipëri – Zgjedhjet Parlamentare, 11 maj 2025 deklaratë e gjetjeve dhe përfundimeve paraprake. Online: <https://www.osce.org/files/f/documents/4/7/590685.pdf>

Përmes analizës së mbi 4,000 artikujve mediatikë, 600 postimeve në rrjete sociale, si dhe raportimeve të drejtpërdrejta nga terreni, monitorimi zbardhi një spektër të gjerë sjelljesh të dëmshme, nga dhuna simbolike dhe verbale, deri te fushata të organizuara të ngacmimit digjital. Këto gjetje dëshmojnë jo vetëm legjitimimin dhe normalizimin e armiqësisë ndaj grave në politikë, por edhe dinamikat kulturore dhe institucionale që lejojnë që kjo dhunë të vazhdojë e paadresuar.

Monitorimi gjithashtu identifikoi mangësi serioze në llogaridhënien institucionale, trajtimin e pabarabartë të grave në median tradicionale, si dhe mospërfshirjen e qartë të DhBGjP në axhendat elektorale të partive politike. Megjithatë, përkundër këtyre sfidave, u evidentuan edhe shembuj të qëndresës qytetare dhe institucionale, si reagime publike kundër gjuhës së urrejtjes. Të gjitha këto gjetje së bashku paraqesin një pasqyrë realiste, ndonjëherë të zymtë, por të domosdoshme për gjendjen e pjesëmarrjes gjinore në politikën shqiptare. Ato nënvizojnë nevojën urgjente për reforma politike, institucionale dhe kulturore për të garantuar një mjedis më të drejtë dhe më të sigurt për gratë në jetën publike dhe politike.

Kandidatët dhe Politikanet Gra

Gjatë periudhës zgjedhore, gratë e angazhuara në politikë kanë qenë veçanërisht në shënjestër e dhunës online. Gjatë muajve prill–maj 2025, në rrjetet sociale u vërejtën postime dhe komente të shumta që lidheshin me pamjen, karakterin apo aftësinë e kandidateve gra, duke shmangur debatin mbi qëndrimet e tyre politike dhe duke i kategorizuar ato si objekte seksi.

Një rast veçanërisht i rëndë lidhet me një incident flagrant të **dhunës me bazë gjinore ndaj znj. Sara Mila**, kandidates së re për deputete të Partisë Socialiste në Qarkun e Elbasanit. Termi ofendues, i përdorur për të denigruar paraqitjen e saj fizike, u përhap gjerësisht në rrjetet sociale dhe u përforcua më tej nga komentues, influencerë dhe analistë politikë. Në mënyrë të veçantë, analisti Andi Bushati e përdori këtë term gjatë emisionit “*Të Paekspozuarit*” më 22 maj 2025, në televizionin MCN TV.¹¹ Ai në vend që të diskutonte idetë apo qëndrimet e saj politike, me komentin e tij kishte si synim poshtërimin dhe përqeshjen e saj mbi baza gjinore, duke përforcuar idenë se gratë në politikë janë subjekte të lira për sulme personale dhe seksiste.

Kjo lloj mizogjinie digjitale është thellësisht e dëmshme, jo vetëm për individin e shënjestruar, por edhe për klimën politike dhe sociale në tërësi. Ky diskutim mizogjinist kontribuon në krijimin e një mjedisi armiqësor, që dekurajon pjesëmarrjen e grave në jetën publike dhe politike. Rasti në fjalë tregon qartë se fyerjet me bazë gjinore janë normalizuar në diskursin politik shqiptar, sidomos gjatë fushatave, kur gratë janë më të dukshme në hapësirën publike. Mbulimi mediatik i këtij episodi seksist u fokusua përgjithësisht në dënimin e gjuhës ofenduese dhe në përforcimin e reagimit të Sara Milës¹², megjithatë trajtimi mediatik ndryshoi tonet dhe fokusin, duke pasqyruar në mënyrë të paqëndrueshme dhe pa pasur në vëmendje

¹¹ <https://www.youtube.com/watch?v=gUSozg2exBw>

¹² javanews.al/

ndjeshmërinë me bazë në trajtimin e rasteve të tilla në media, të cilat gjithashtu kishin qasje të ndryshme nga njëra tjetra për mënyrën se si raportuan rasti.

Për shembull, Gazeta Dita, e cila raportoi fillimisht incidentin, evidentoi që në titull fjalën e papërshtatshme të përdorur nga analisti duke përshkruar edhe reagimin e ashpër që Sara Mila përjetoi në rrjetet sociale. Megjithëse artikulli nuk e dënoi drejtpërdrejt z. Bushati, i cili përdori këtë term, artikulli vinte në dukje se komenti ishte seksist dhe poshtërues, dhe në mënyrë të tërthortë kritikonte gjuhën e ashpër të debatit publik.

Nga ana tjetër, Gazeta Tema u fokusua më shumë në reagimin e Sara Milës, duke e paraqitur atë si një kandidate të re që përballlet me mizogjininë online. Tema, citoi Sara Milen duke e quajtur analistin “ngacmues i frustruar”¹³ dhe duke mbrojtur të drejtën e saj për të qenë pjesë e politikës pa iu nënshtruar fytyrëve dhe paragjytimeve me bazë gjinore. Ky artikull i dha zë narrativës së saj duke përshkruar këtë gjuhë si pjesë të një modeli më të gjerë armiqësie me bazë gjinore ndaj grave në politikë.

Në të dy rastet, raportimi ishte më empatik dhe mbështetës ndaj znj. Mila sesa neutral apo kritik. Edhe pse emri i Andi Bushatit nuk u përmend gjithmonë drejtpërdrejt apo nuk u dënua në mënyrë të zgjeruar, kornizimi i përgjithshëm i lajmit anonte drejt mbrojtjes së dinjitetit të znj. Milës dhe theksonte papërshtatshmërinë e përdorimit të fytyrëve me tone degraduese ndaj grave në diskursin politik. Media, në këtë mënyrë, luajti një rol të rëndësishëm në vënien në dukje të problemit, edhe pse jo të gjitha mediat sfiduan haptazi kulturën që normalizon përdorimin e kësaj gjuhe.

Një shembull tjetër është **rasti i deputetes së Partisë Demokratike, znj. Albana Vokshi**, e cila denoncoi dhunën me bazë gjinore në jetën politike. Në disa fjalime dhe paraqitje mediatike, ajo theksoi se gratë në politikë jo vetëm që përjashtohen nga proceset vendimmarrëse, por përballen në mënyrë aktive me kërcënime dhe ngacmime. Veçanërisht, gjatë fjalimit të saj në Asamblenë e Forumit të Partive të Qendrës së Djathtë Evropiane (IDC-CDI), znj. Vokshi përshkroi se ajo dhe vajza e saj ishin shënjestruar personalisht me kërcënime nga subjekte kriminale, të cilët, sipas saj, kishin lidhje me partinë në pushtet. Ajo e përshkroi këtë si pjesë të një modeli më të gjerë të intimidimit zgjedhor, ku gratë kandidate ekspozohen në mënyrë disproporcionale ndaj sulmeve të koordinuara. Në fjalën e saj znj. Vokshi tha: *“Unë u fyeva, u intimidova dhe u kërcënova vazhdimisht. Familja ime, vajza ime, u kërcënuan nga të njëjtët persona që unë i kisha raportuar te mekanizmi i posaçëm i ngritur për të parandaluar dhunën, krimin elektoral. Por jo vetëm që ata nuk arritën të më mbrojnë mua dhe familjen time, por ata nuk arritën të parandalojnë asnjë krim zgjedhor, sepse rrjeti i patronazhimit dhe kartelet e drogës ishin ata që vendosnin për votën. Policia nuk bëri asgjë. SPAK nuk bëri asgjë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëri sikur nuk pa asgjë.”*

Në mbulimin mediatik, për shembull “Vokshi flet në asamblenë e CDI: “Demokracia u rrëzua nga krimi”¹⁴ dhe “Vokshi në asamblenë e IDC-CDI: Në farsën e 11 Majit, demokracia u rrëzua

¹³ <https://www.gazetatema.net/politika/nje-buallice-sara-mila-i-kthehet-andi-bushatit-nje-bullizues-i-frustuar-i496049>

¹⁴ Syri.net [SYRI TV / 11 maj]

nga krimi dhe dhuna”¹⁵, dëshmia e saj nënvizoi se pjesëmarrja politike e grave po minohej jo vetëm nga dështimet institucionale, por edhe nga intimidimi gjinor.

Albana Vokshi, Deputete e Parlamentit Shqiptar, Kryetare e Lidhjes Demokratike të Gruas është një zë i fuqishëm në luftën kundër dhunës me bazë gjinore. Në artikuj si “Dhuna ndaj grave, Vokshi kërkon: Dënime më të ashpra për autorët, do luftojmë për sigurinë e tyre”¹⁶ dhe në artikullin “Të paprekshme” / Vokshi shprehu shqetësimin për rritjen e rasteve të dhunës ndaj grave në Shqipëri, duke e cilësuar një rast tragjik – ku një grua u plagos nga bashkëshorti i saj – si pasqyrë të krizës së thellë shoqërore. Ajo theksoi se shteti duhet të reagojë me seriozitet, duke ndalur pandëshkueshmërinë dhe frikën në të cilën jetojnë shumë gra. Vokshi deklaroi se Partia Demokratike, do të angazhohet për mbrojtje të pakompromis të grave dhe propozoi: Dënime më të ashpra për autorët e dhunës; Masa mbrojtëse pa pengesa burokratike; Mbështetje konkrete për qendrat e strehimit dhe organizatat që ndihmojnë viktimat. “Deklarata e saj ishte një thirrje e fortë për veprim të menjëhershëm institucional dhe për t’i dhënë fund një klime të dhunshme ndaj grave dhe pandëshkueshmërisë së dhunuesve.”¹⁷, ajo kërkoi dënime më të ashpra për autorët e dhunës dhe theksoi nevojën për masa më të forta mbrojtëse institucionale për gratë në jetën publike.

Gjatë fushatës zgjedhore 2025, u shënua një sulm ndaj znj. **Elisa Spiropali, Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë** dhe një figurë udhëheqëse e Partisë Socialiste në pushtet. Gjatë një seance parlamentare të tensionuar më 29 maj 2025, deputeti i Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, e akuzoi Spiropalin se kishte organizuar Konferencën e Kryetarëve për “të bërë fotografi,” duke e hedhur poshtë aspektin institucional si një shfaqje për mendjemadhësi dhe jo si një akt qeverisës legjitim. Ai shkoi më tej, duke pretenduar se ajo bashkëpunonte me një bandë kriminale.¹⁸ Megjithëse komentet e Bardhit nuk përmbanin fyerje të hapura seksiste, sulmi i tij i shumëfishtë përmbante elementë të koduar gjinorë, duke vënë në dyshim besueshmërinë e Spiropalit, duke nënkuptuar lidhjen e saj me struktura kriminale të dominuara nga burra dhe duke e zvogëluar rolin e saj institucional në një performancë estetike.

Artikulli në platformën syri.net¹⁹ dhe mënyra se si u ndërtua sulmi verbal ndaj Elisa Spiropalit përfaqëson një shembull tipik të dhunës së koduar me bazë gjinore në politikë, që nuk shprehet përmes ofendimeve eksplicite seksiste, por përmes nënkuptimeve dhe simbolikave që sulmojnë figurën publike të një gruaje në mënyrë sistematike. Ky sulm tenton të minimizojë rolin institucional të grave në politikë. Duke e akuzuar Spiropalin se kishte organizuar një *seancë për të bërë fotografi*, Bardhi i atribuoi asaj një rol të pavlerë, që lidhet me paraqitjen fizike dhe jo në përmbajtje. Kjo është një taktikë e njohur e delegjitimitimit gjinor që e redukton kontributin e grave në politikë në aspekte estetike dhe të pavlera, duke mos i njohur autoritetin, kompetencën apo pozicionin e tyre zyrtar. Gjithashtu, përmendja e lidhjes me një grup kriminal nuk është vetëm një akuzë politike, duke nënkuptuar që një grua nuk mund të jetë pjesë e qeverisjes pa qenë e lidhur me burra të fuqishëm në këtë rast edhe të dyshimtë, duke i mohuar autoritetin dhe aftësinë për vendimmarrje.

¹⁵ BoldNews.al

¹⁶ Sot.com.al

¹⁷ Syri.net

¹⁸ <https://qijotina.com/>

¹⁹ <https://www.syri.net/politike/>

Znj. Milva Ekonomi, deputete e profilit të lartë e Partisë Socialiste dhe ish-ministre, në përgjithësi nuk ishte pjesë e kontestimeve me bazë gjinore gjatë fushatës elektorale të vitit 2025. Megjithatë, disa narrativa mediatike pasqyruan formë të fshehta të delegjitimitimit dhe kornizimit gjinor, veçanërisht përmes metaforave dhe fshirjes selektive të zërit të saj politik. Në një panel televiziv të mbuluar në platformën YouTube *“Flamur Noka përplasjet me Milva Ekonomin: Je ushtar e Ramës”*²⁰, deputeti i opozitës Flamur Noka iu referua vazhdimisht Ekonomit si “ushtar e Ramës”, një shprehje retorike e përdorur shpesh për të delegjitimuar gratë në politikë duke nënkuptuar nënshtrim ndaj autoritetit mashkullor. Edhe pse jo në mënyrë eksplicite mizogjene, kjo gjuhë pasqyron paragjykime të rrënjësura gjinore që zvogëlojnë autonominë e politikaneve dhe forcojnë hierarkitë patriarkale në diskursin politik. Dallimi gjinor në përdorimin e termit “ushtar/e” është thelbësor për të kuptuar efektin e tij nënvlerësues: te burrat, fjala “ushtar” zakonisht ka konotacione pozitive si besnikëri, disiplinë dhe përkushtim ndaj një kauze apo lideri. Ndërsa kur përdoret për gratë, “ushtar” shpesh nënkupton mungesë autonomie, duke i paraqitur si ndjekëse të verbra të një lideri mashkullor dhe jo si aktore të pavarura politike me zë dhe mendim të vetin..

Gjithashtu, në artikullin “Deputetët ekonomistë në Parlament, nga Milva Ekonomi te Arbi Agalliu”²¹, Ekonomi renditet mes deputetëve të tjerë sipas profesionit, por arritjet apo platforma e saj politike nuk përmenden. Ky është një shembull se si gratë shpesh mënjanojnë në etiketa profesionale në mbulimin mediatik, pa analizën e thelluar që u ofrohet homologëve burra. Kjo mungesë përfaqësimi kontribuon në një formë të fshirjes simbolike, një dimension tjetër i marginalizimit politik me bazë gjinore.

Së fundmi, në mbulimin më të gjerë të deputetëve të rinj, si “Lista përfundimtare e deputetëve të rinj të PS”²², emri i Ekonomit përmendet pa ndonjë fokus individual apo përmendje të kontributit të saj elektorale, duke sugjeruar sërish se prania e saj u perceptua si formale dhe jo si ndikim politik i mirëfilltë.

Ndërsa Ekonomi nuk ishte objekt i ngacmimeve të hapura apo gjuhës së urrejtjes, mënyra se si ajo u paraqit, ose jo në disa burime mediatike, nxjerr në pah se paragjykimi gjinor mund të shfaqet përmes mungesës së përfaqësimit, gjuhës që minimizon rolin e grave apo metaforave delegjitimuese. Këto strategji janë pjesë e një modeli më të gjerë të dhunës simbolike që ndikojnë në pjesëmarrjen e plotë të grave në politikë.

Znj. Iris Luarasi, një figurë mediatike e spikatur si gazetare dhe aktiviste për të drejtat e njeriut dhe kandidate e re nga Partia Socialiste, ka ngritur për diskutim në mënyrë aktive çështjet që lidhen me dhunën me bazë gjinore dhe mbrojtjen nga ana e shoqërisë civile për këtë kategori në Shqipëri. Në disa dalje mediatike, Luarasi ka theksuar se organizatat e shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e grave janë objekt i kritikave të ashpra dhe një mjedisi shoqëror armiqësor. Në mënyrë të veçantë, në artikullin “Kandidate për deputete e PS-së! Iris Luarasi: Shoqëria civile po sulmohet ashpër”²³, ajo adresoi hapur reagimet e ashpra që merr shoqëria civile për shkak të qëndrimeve të saj në mbrojtje të barazisë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje.

²⁰ A2 CNN, 31 maj 2025

²¹ Telegraf.al, 6 maj 2025

²² Syri.net, 14 maj 2025

²³ <https://lexo.al/2025/04/>

Po ashtu, mbulimi mediatik si në artikullin "Një zë për gratë në parlament, Iris Luarasi në listën e PS: Dhuna në familje s'ka justifikim"²⁴, e portretizoi në mënyrë pozitive, duke theksuar angazhimin e saj të fortë kundër dhunës në familje, ndërkohë që në mënyrë të nënkuptuar vlerësohej edhe rezistenca që znoj. Luarasi dhe aktivistë të tjerë përballen në shoqëri për këto çështje.

Gjatë debateve politike, siç përshkruhet në "Opinion – Rama apo Berisha, kush po e dominon..."²⁵, Luarasi u përball me kritika të nënkuptuara por përçmuese, që vinin në dyshim besueshmërinë dhe gjykimin e saj politik, duke reflektuar një paragjykim gjinor të thellë në diskursin politik.

Për më tepër, mbështetja pozitive nga grupe të shoqërisë civile, përfshirë edhe fushatën e Partners Albania "#30vjetshoqëricivile #tëdrejta..." (7 prill 2025), theksonte përkushtimin e saj afatgjatë për të luftuar dhunën me bazë gjinore, ndërkohë që vërehej edhe rezistenca e madhe shoqërore ndaj avokatëve si ajo.

Në përgjithësi, narrativat mediatike rreth Iris Luarasit pasqyrojnë një model ku gratë që advokojnë në mënyrë aktive për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore përballen shpesh me përjekje për t'u delegjitimuar dhe me kundërshtime të forta nga shoqëria.

Aktivistet dhe Gazetaret Gra

Përtej kandidateve, edhe aktivistet dhe gazetaret gra që ngritën zërin për dhunën me bazë gjinore (DhBGj) u përballën me armiqësi në internet, trend shqetësues i cili vijoi gjatë periudhës zgjedhore të vitit 2025. Aktivistet që promovuan ndërgjegjësimin mbi DhBGj apo që kritikuan publikisht mungesën e një platforme kundër DhBGj nga partitë politike, u përballën me sulme, përgojim dhe shpesh herë me publikimin e të dhënave personale nga llogari anonime në rrjetet sociale.

Një shembull konkret është znoj. **Sidorela Vatnikaj**, aktiviste për të drejtat e grave, e cila foli hapur në një emision televiziv kombëtar për dështimin e shtetit në adresimin e rritjes së dhunës në familje dhe divorceve. Gjatë intervistës, ajo theksoi nevojën për reforma institucionale dhe për shërbime mbështetëse për gratë. Pas kësaj paraqitjeje, Vatnikaj u përball me një valë ngacmimesh dhe komentesh përçmuese online, çka tregon se gratë që flasin hapur shpesh ndëshkohen me abuzim digjital. Rasti u raportua nga Syri.net më 28 maj 2025.


Komente Online me Gjuhë Urrejtjeje të Lidhura me Dhunën me Bazë Gjinore (DhBGj)

Gjatë periudhës që u realizu monitorimi, në të gjitha artikujt që trajtonin dhunën ndaj grave apo grave në politikë, nga mbi 38 mijë komente të analizuara, rreth 660 prej tyre janë kategorizuar si komente me gjuhë urrejtjeje.

²⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=iB7kT1SsUJ0>


²⁵ <https://www.youtube.com/watch?v=aizSyRhj8z8>

















































Figura 1. Çështja dhe komentet me gjuhë urrejtje



Analiza tregon se nuk ka dallim të dukshëm në shfaqjen e gjuhës së urrejtjes midis grave dhe burrave politikanë, kur një politikanë përmendet në një artikull apo postim, komente me gjuhë urrejtjeje shfaqen po aq sa edhe në rastet kur përmenden kolegët e tyre burra.

Figura 2. Tridhjetë politikanët më të përmendur me komente me gjuhë urrejtjeje në Shqipëri gjatë periudhës prill-maj 2025



Kandidatët	Komente me Gjuhë Urrejtjeje	% Gjuhës së Urrejtjes	Komente	Postime në Rrjete Sociale
 Xhelal Mziu Xhelal Mziu (1228/17782), Euronews Albania (81/780), Gazeta TemA (76/459)...				
 Lulzim Basha Lulzim Basha (1227/22900), Faktoral (51/432), Gazeta TemA (31/240), Euronews...				
 Fredy Beleri Euronews Albania (377/1275), Gazeta TemA (140/583), Φρέντης Μπελέρης – Fredy Beleri...				
 Gazment Bardhi Gazment Bardhi (561/11711), Shqiptarja.com (123/1166), Euronews Albania (74/676)...				
 Erion Veliqaj Erion Veliqaj (242/11959), Belind Këlliçi (114/938), Euronews Albania (102/940)...				
 Jozefina Topalli Jozefina Çoba Topalli (259/4120), Euronews Albania (181/1241), Syri TV (93/718), Gazeta...				
 Tomor Alizoti Shqiptarja.com (128/607), Tomor Alizoti (116/3916), Gazeta TemA (115/944), Top...				
 Adriatik Lapaj Euronews Albania (171/1464), JOQ Albania (97/817), Bledi Mane (80/1037), Gazeta...				
 Jorida Tabaku Jorida Tabaku (501/19602), Euronews Albania (56/607), Gazeta TemA (45/530)...				
 Olta Xhaçka Euronews Albania (410/1547), Ora News (325/1444), Jnuglajm (282/1289), Lapsi.al...				
Kandidatët	Komente me Gjuhë Urrejtjeje	% Gjuhës së Urrejtjes	Komente	Postime në Rrjete Sociale
 Endrit Shabani Dr. Endrit Shabani (673/16206)				
 Ilir Metaj Ilir Metaj (272/5460), Erisa Xhihi (70/1248), Ora News (384/1854), Petrit Vasil...				
 Benet Beci Benet Beci (175/12667), TV Rozafa (69/348), ShkodraWeb (52/364), Sprint.al...				
 Fatmir Mediu RTSH Radio Televizioni Shqiptar (112/385), Euronews Albania (77/323), Gazeta...				
 Monika Kryemadhi Euronews Albania (127/673), Dritare TV (83/412), Gazeta TemA (79/332), Opinion T...				
 Blerina Gjylameti Blerina Gjylameti (354/6612), Euronews Albania (51/236), Tirana News (26/110), Ora...				
 Ilirjan Celibashi Syri TV (158/606), Euronews Albania (117/558), Ora News (94/426), Tvklan...				
 Artind Qori Dritare TV (143/1268), Bledi Mane (68/439), Lapsi.al (52/408), Argjirioja.net (41/236)...				
 Ulsi Manja Ulsi Manja (276/8194), Euronews Albania (38/152), Ora News (33/147), Opinion TV...				
 Sara Mila JOQ Albania (140/1134), Shqiptarja.com (34/312), News24 (33/224), Sali Berisha...				

Vlen të theksohet se mjedisi i përgjithshëm informativ gjatë zgjedhjeve ishte shumë i polarizuar dhe i prirur ndaj përmbajtjeve manipuluese, ashtu siç u vu në dukje nga vëzhguesit e zgjedhjeve të OSBE ODIHR. Ata theksuan se përdorimi aktiv i rrjeteve sociale nga kandidatët dhe

mbështetësit e tyre “forcoi më tej diskursin përçarës dhe përballës” dhe se asnjë autoritet publik nuk ishte caktuar për të zbuluar apo frenuar përmbajtjet manipuluese apo të dëmshme në internet²⁶. Mungesa e një mbikëqyrjeje zyrtare bëri që shumë nga gjuha e urrejtjes dhe dezinformimi që kishin në shënjestër gratë të përhapeshin pa u kontrolluar.

Facebook dhe Instagram, ndonëse në teori kanë standard kundër gjuhës së urrejtjes (përfshirë atë me bazë gjinore), zbatimi i këtyre standardeve në kontekstin e gjuhës shqipe ishte i dobët. Pak përdorues raportonin postimet abuzive dhe kur kjo ndodhte, përmbajtja nuk fshihej gjithmonë në kohë. Ka raportime të përsëritura për kandidate gra që zgjidhnin të kufizonin ose të çaktivizonin komentet në postimet e tyre për të shmangur valën e ngacmimeve, një zgjidhje e përkohshme që fatkeqësisht kufizon edhe angazhimin e vërtetë publik.

Shembuj të komenteve me gjuhë urrejtjeje

Dhuna me bazë gjinore në sferën digjitale vazhdon të jetë pjesë e pandashme dhe e dëmshme e diskursit politik, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore. Gjatë zgjedhjeve parlamentare të këtij viti, gratë kandidate, figura publike dhe deputete ishin të ekspozuara ndaj gjuhës së urrejtjes në internet, duke përfshirë kërcënimet, fyerjet seksualizuese dhe përpjekje për delegitimim. Këto sulme nuk synonin vetëm të minonin besueshmërinë e tyre politike, por gjithashtu kishin për qëllim t'i trembnin, t'i bënin të heshtnin dhe t'i përjashtonin nga hapësira publike.

Një rast domethënës përfshin **Luljeta Bozon**, pedagoge në pension dhe deputete, e cila u bë objekt i një sërë komentesh me gjuhë urrejtjeje në platformat e mediave sociale. Sulmet e bëra në seksionet e komenteve të faqeve të njohura mediatike përfshinin gjuhë të dhunshme, mizogjiniste dhe diskriminuese lidhur me moshën. Në shumë raste, Bozo u sulmua jo për shkak të politikave apo deklaratave të saj publike, por për shkak të gjinisë, moshës dhe përkatësisë së saj politike.

Në seksionin vijues paraqiten raste konkrete për të ilustruar intensitetin dhe natyrën e gjuhës së urrejtjes në internet, përfshirë sulmet ndaj grave si Elisa Spiropali, Olta Xhaçka, Jozefina Topalli, Belinda Balluku dhe të tjera. Shembujt theksojnë një model të sulmeve të bazuara në gjini dhe ekspozimin në sferën publike, të cilat shpesh përshkallëzohen në fyerje vulgare, poshtërim dhe kërcënime të drejtpërdrejta. Këto komente pasqyrojnë mizogjininë strukturore që vazhdon të pengojë pjesëmarrjen e plotë të grave në jetën politike në Shqipëri.

Faqja në Facebook e A2 CNN, ilustron qartë ndërthurjen midis dezinformimit politik dhe gjuhës së urrejtjes me bazë gjinore. Përdorues të shumtë iu referuan **Olta Xhaçkës** me gjuhë tërësisht të ngarkuar mizogjene dhe çnjerëzore, duke e portretizuar si një kërcënim moral dhe politik. Disa komente shkonin deri aty sa kërkonin arrestimin e saj ose përmendnin dënime fizike, çka tregon një normalizim shqetësues të ideve ndëshkuese ndaj grave në poste publike.

Këto sulme nuk kufizoheshin vetëm në rolin e saj politik, por përfshinin narrativa më të gjera kundër grave dhe kundër demokracisë, duke nënkuptuar se Xhaçka dhe gra të tjera si ajo janë

²⁶https://www.osce.org/files/f/documents/4/f/590598_4.pdf#:~:text=plurality%20of%20neës%20sources%2C%20along,new%20coordination%20mechanism%20among%20institutions

pjesë e një elite të korruptuar që meriton ndëshkim. Shembuj të tillë nuk përfaqësojnë vetëm armiqësi individuale, por tregojnë një kulturë të organizuar të dhunës digjitale me bazë gjinore, ku gratë në politikë delegjitimohen jo për shkak të politikave të tyre, por për shkak të gjinisë dhe prezencës të tyre publik.

Abuzimi digjital i drejtuar ndaj **Belinda Ballukut, Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë**, është një shembull tjetër se si gjuha e urrejtjes me bazë gjinore ndërthuret me pakënaqësinë politike. Në një postim të Euronews Albania mbi hapjen e tunelit të Llogarasë, Balluku u bë objekt i një vërshimi fyerjesh seksiste, sharjesh mizogjene dhe gjuhe delegjitimuese, megjithëse artikulli kishte një fokus neutral mbi një projekt infrastrukturor.

Në seksionin e komenteve, Balluku u etiketua si pjesë e një rrjeti më të gjerë korrupsioni dhe shpesh përshkruhej si “pronë e Edi Ramës”. Komentet përfshinin referenca seksuale fyese, duke e reduktuar rolin e saj profesional në metafora banale dhe gjuhë të dhunshme.

Ish-Kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli, u përball gjithashtu me një sërë sulmesh të ashpra në internet dhe abuzimesh verbale pas pretendimeve të saj për manipulime të gjera zgjedhore, sidomos në seksionet e komenteve të postimeve të Syri TV në Facebook. Shumë nga këto komente i kalonin kufijtë e një mosmarrëveshjeje politike dhe hynin në territorin e sulmeve të bazuara në gjini dhe moshë, duke minuar besueshmërinë e saj si grua në jetën publike. Përdoruesit, përdornin shprehje që kombinonin sharje mizogjinie me fyerje mbi moshën, për ta delegjitimuar pjesëmarrjen e saj politike.

Komentet e tjera sugjerorin se ajo ishte pjesë e një “bande të rrezikshme” dhe “me vrasësit”, duke përforcuar stereotipin e politikanës manipuluese apo të korruptuar, veçanërisht për ato me karrierë të gjatë. Këto sulme pasqyrojnë një tendencë më të gjerë në hapësirat dixhitale shqiptare, ku gratë në politikë nuk kundërshtohen vetëm për qëndrimet e tyre, por përbuzen përmes një gjuhe thellësisht personale dhe mizogjiniste.

Elisa Spiropali, Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë, deputete e njohur e Partisë Socialiste dhe figurë publike e spikatur, ka qenë objekt i sulmeve të vazhdueshme në internet, të karakterizuara nga një gjuhë urrejtjeje mizogjene, çnjerëzore dhe të motivuar politikisht. Gjatë periudhës së monitorimit të zgjedhjeve të vitit 2025, në një sërë postimesh të analizuara në Facebook, seksionet e komenteve pasqyronin një diskurs jashtëzakonisht problematik që e kishte në shënjestër në mënyrë disproporcionale për shkak të gjinisë dhe rolit të saj politik.

Ndër modelet më të shpeshta të sulmeve u evidentuan:

- **Fyerje mizogjene dhe komente seksiste**, të cilat synonin të cenonin dinjitetin e saj përmes poshtërimit të drejtpërdrejtë gjinor dhe përdorimit të metaforave denigruese.
- **Gjuhë e ngarkuar me kërcënime dhe sugjerime për dhunë**, përfshirë komente që nënkuptonin largimin e saj nga jeta publike ose që nxisnin arrestimin e saj.
- **Sulme mbi rolin e saj si nënë dhe mbi edukimin**, me komente sarkastike që përpiqeshin të diskreditonin moralin dhe përshtatshmërinë e saj për të ushtruar një funksion publik.
- **Delegjitimim politik me ngarkesë gjinore**, ku akuzat për korrupsion shoqëroheshin me gjuhë seksualizuese për të ulur autoritetin e saj.

- **Fajësim i viktimës dhe kontrolli moral**, me komente që e akuzonin se kishte sjellë turp mbi gratë dhe nënat shqiptare përmes angazhimit të saj në politikë.

Këto shembuj dëshmojnë për një ambient armiqësor dhe thellësisht patriarkal në sferën publike dhe dixhitale, ku gratë me ekspozim të lartë politik vazhdojnë të jenë objekt i dhunës simbolike dhe verbale të mbështetur nga stereotipe gjinore.

Albana Vokshi, deputete e njohur e Partisë Demokratike dhe një prej figurave më të spikatura në jetën politike shqiptare, u bë objekt i një vale të konsiderueshme abuzimesh verbale në rrjet gjatë fushatës së zgjedhjeve të vitit 2025. Kjo valë u evidentua sidomos në komente në Facebook mbi një postim të RTSH – Radio Televizioni Shqiptar, i cili përfshinte deklarata të Vokshit në lidhje me situatën politike. Komentet në fjalë evidentuan një diskurs të ngarkuar me gjuhë urrejtjeje, mizogjini dhe fyerje të rënda, duke tejkaluar kufijtë e debatit politik dhe duke hyrë në sferën e dhunës me bazë gjinore.

Shumë prej komenteve synonin ta delegjitimonin Vokshin jo përmes kritikës ndaj qëndrimeve apo ideve të saj politike, por përmes fyerjeve seksiste që e reduktonin atë në gjininë dhe seksualitetin e saj. Në vend që të merreshin me rolin e saj politik, komentuesit përdornin etiketime dhe insinuata banale, të cilat nuk ishin vetëm sulme personale, por përfaqësonin një strategji të qëllimshme për të turpëruar dhe heshtur gratë që janë aktive në jetën publike. Kjo është një formë klasike e dhunës me bazë gjinore në hapësirën digjitale.

Përveç fyerjeve seksiste, komentet shpesh përmbanin gjuhë çnjerëzore dhe urrejtje. Kishte referenca ndaj akteve të dhunës, përdhunimit, incestit dhe poshtërimit, që shtriheshin madje edhe ndaj familjarëve të saj. Metaforat e përdorura synonin t'ia mohonin Vokshit jo vetëm autoritetin si politikanë, por edhe dinjitetin si grua.

Gjithashtu, në shumë komente vihej re një mungesë e plotë respekti për normat ligjore dhe etike. Kërcënimet dhe nxitja për dhunë ishin të drejtpërdrejta, duke shkelur jo vetëm standardet e komunitetit të platformave sociale, por edhe ligjet shqiptare që ndalojnë gjuhën e urrejtjes, shpifjen dhe nxitjen e dhunës. Kjo tregon për një mungesë serioze të kontrollit dhe ndëshkueshmërisë ndaj dhunës verbale në internet, veçanërisht kur ajo i drejtohet grave në politikë.

Rastet e Elisa Spiropalit dhe Albana Vokshit nuk janë të izoluara. Ato dëshmojnë për një kulturë të rrënjosur të mizogjinisë digjitale që ndëshkon gratë politikanë në jetën publike për vetë faktin që guxojnë të flasin dhe të marrin pjesë. Ky realitet kërkon jo vetëm vëmendje institucionale, por edhe një reagim të fortë shoqëror për të garantuar që pjesëmarrja e grave në politikë të mos shoqërohet me dhunë, por me respekt dhe barazi.

Erisa Xhixho, deputete e Partisë së Lirisë, u përball me një valë të vazhdueshme dhe të koordinuar të gjuhës së urrejtjes dhe delegjitimitit gjinor gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2025, veçanërisht në platformën Facebook. Retorika dominuese kundër saj u përqendrua në dy korniza të përsëritura: (1) akuza si bashkëfajtoreshë në korrupsionin; dhe (2) narrativë mizogjiniste mbi moralin dhe aftësinë profesionale.

Në postimet e analizuar nga faqja e saj zyrtare dhe në mediat që pasqyrojnë aktivitetin e saj, komentet zbulojnë një ton jashtëzakonisht armiqësor. Dhjetra përdorues kanë drejtuar fyerje, etiketime banale që lidhen me aspektin fizik dhe gjuhë denigruuese, duke e lidhur edhe me familjarët e saj.

Dhjetra përdorues kanë përdorur fyerje, etiketime banale që lidhen me aspektin fizik dhe gjuhë e ulët migjenike dhe seksiste, duke e lidhur edhe me familjarë. Ndryshe nga sulmet ndaj disa kandidatëve të tjerë, që fokusoheshin më tepër në kritikën ndaj platformës politike, sulmet ndaj Xhixhos ishin thellësisht të personalizuar dhe lidhura me moralin, duke pasqyruar një standard të dyfishtë gjinor ndaj politikaneve gra ku përmes gjuhës mizogjene vihet në dyshim performanca profesionale. Gjithashtu, mosha dhe pamja e saj fizike u përdorën nga komentuesit duke e akuzuar se arritjet e saj politike lidheshin me dukjen e jashtme dhe jo meritën.

Edhe në komentet online **Sara Mila**, një kandidate e re që garoi në Qarkun e Elbasanit, u bë objekt i një vale të gjuhës mizogjene dhe poshtëruese në Facebook, veçanërisht pas një postimi ku ajo shprehte emocionalisht mirënjohjen për mbështetjen nga 18,000 votues. Megjithëse postimi i saj ishte një mesazh falënderimi dhe qëndrueshmërie, komentet përmbanin një nivel të thellë të gjuhës së urrejtjes online, të lidhura kryesisht në paragjykime gjinore, pamjen e saj fizike dhe përkatësinë e saj politike.

Komentet e shumta synonin të minimizonin suksesin e saj përmes fyerjeve ndaj pamjes së jashtme, duke përdorur gjuhë çnjerëzore dhe seksiste që synonte ta paraqiste si të papërshtatshme dhe të pavlerë për rolin publik. Komente të tjera vinin në dyshim legjitimitetin e saj si kandidate, duke sugjeruar se ajo kishte fituar votat vetëm për shkak të lidhjeve me krimin, duke përforcuar idenë se gratë në politikë janë thjesht vegla të rrjeteve mashkullore politike ose kriminale.

Përtej fyerjeve gjinore, një temë e vazhdueshme ishte përçmimi klasor. Përdoruesit e tallnin për emocionet e shprehura, duke nënkuptuar se ajo nuk kishte “formimin e duhur” për një rol publik, si në aspektin arsimor ashtu edhe në statusin shoqëror.. Komentet përçmuese forcan narrativën se gra si Sara Mila — të reja, emocionale dhe me perceptimin se janë ngritur në status shoqëror — nuk duhen marrë seriozisht në politikë.

Në disa raste, komentuesit përdorën edhe poshtërim seksual të tërthortë, duke nënkuptuar se rezultatet e saj elektorale ishin arritur përmes nënshtrimit ndaj burrave me pushtet, duke përforcuar një stereotip që mohon aftësinë dhe suksesin e grave. Kjo përputhet me modelet më të gjera të dezinformimit gjinor, ku pjesëmarrja politike e grave zhbëhet përmes narrativave që i paraqesin ato si të korruptuara moralisht ose seksualisht.

Ajo që e bën këtë rast veçanërisht tregues është ndërthurja e mizogjinisë me skepticizmin ndaj mediave. Komentuesit jo vetëm që sulmuan drejtpërdrejt Sara Milën, por shtrinë urrejtjen edhe ndaj gazetarëve dhe prezantuesve televizivë që raportuan për të, duke akuzuar mediat si propagandë dhe se “gënjejnë publikun”. Kjo goditje e shumëfishtë reflekton një ekosistem mosbesimi, ku si gratë politike, ashtu edhe gratë gazetare shihen si bashkëpunëtore në një sistem të korruptuar.

Reagimet Institucionale dhe Civile

Së fundmi, monitorimi regjistroi edhe ngjarje që nuk përbënin domosdoshmërisht akte dhune, por që lidhen me parandalimin ose reagimin ndaj dhunës me bazë gjinore – në thelb, “ana pozitive” e medaljes. Këto përfshijnë fushata ndërgjegjësimi publik, veprime qytetare dhe masa institucionale që sinjalizojnë një rritje përfshirjeje në drejtim të drejtësisë gjinore. Një shembull i spikatur ishte mbulimi mediatik i nënshkrimit të Kodit të Sjelljes për Fushatat Digjitale, që ka për qëllim frenimin e gjuhës së urrejtjes dhe garantimin e një komunikimi etik në hapësirat online gjatë fushatës zgjedhore. Edhe pse nuk lidhej drejtpërdrejt me dhunën, kjo nismë, e cituar në artikuj si “Firmoset kodi për fushatat online: Etika në komunikim dhe ndalim i urrejtjes”²⁷ ishte e lidhur qartazi me krijimin e një mjedisi më të sigurt digjital, veçanërisht për gratë kandidate dhe aktiviste që përballen me mizogjini online.

Të gjitha partitë kryesore politike nënshkruan këtë kod vullnetar, duke u zotuar, ndër të tjera, të “promovojnë debat të civilizuar dhe të shmangin gjuhën e urrejtjes në komunikimet digjitale”. Kjo nismë, e mbështetur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me ndihmën e organizatave ndërkombëtare si International IDEA dhe NDI, synonte të vendoste një ton pozitiv për zgjedhjet e majit 2025 dhe të luftonte abuzimin online.

Kodi i Sjelljes u mirëprit si një hap i rëndësishëm, që sinjalizonte vullnetin politik për të ulur sjelljet më të këqija në hapësirat online. Megjithatë, ndikimi i tij varej nga mënyra se si partitë do të kontrollonin përmbajtjen e përkrahësve të tyre. Gjatë fushatës pati ende shumë shkelje të frymës së këtij kodi – veçanërisht nga faqe të mbështetësve jozyrtarë të partive ose nga militantë, postimet e të cilëve nuk mund të atribuoheshin lehtësisht të kanalet zyrtare të fushatës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe disa organizata monitoruese të shoqërisë civile kryen monitorim të kufizuar të rrjeteve sociale dhe shënuan disa raste flagrante të gjuhës së urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore. Këto raste u denoncuan publikisht, por nuk u ndërmorën masa ligjore, pasi Kodi i Sjelljes për fushatat online kishte natyrë vullnetare dhe nuk parashikonte penalitete. Mediat gjithashtu pasqyruan deklaratat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda, i cili ngriti shqetësime për gjuhën e përdorur nga politikanët gjatë fushatës në Shqipëri. Ai theksoi se gjuha e urrejtjes dhe e paragjykitimeve përbënte një kërcënim serioz për barazinë dhe përfshirjen në jetën publike.

Në mesin e majit, disa ngjarje të organizuara nga shoqëria civile morën vëmendje mediatike. Një protestë paqësore e të rinjve në Tiranë, e mbuluar nga media në artikullin “Rinia kundër dhunës gjinore: Protestë paqësore në qendër të kryeqytetit”²⁸, solli mesazhe të forta kundër dhunës ndaj grave përmes pankartave me mbishkrime si “Jo Dhunës ndaj Grave”. Këto gjeste simbolike ishin shprehje e një dëshire të madhe për ndryshim në rrënjë të shoqërisë.

Rrjeti për Fuqizimin e Grave Shqiptare dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile luajtën një rol kyç në amplifikimin e reagimeve, përmes mesazheve si “Mos heshtni: Dhuna është krim, jo pasion”

²⁷ Top Channel, 18 prill 2025

²⁸ Publik tv, 15 maj 2025

dhe “Ndryshimi fillon me ne – Reagim ndaj vrasjeve të grave”. Po ashtu, organizata si Komiteti Shqiptar i Helsinkit reagues me deklarata publike për gjuhën e përdorur në fushatën zgjedhore dhe heshtjen institucionale.

Edhe pse në numër më të vogël, këto reagime luajnë një rol kyç në narrativën më të gjerë. Ato zhvendosin fokusin nga viktimizimi drejt përgjegjësisë kolektive dhe përfshirjes qytetare, duke dëshmuar se, përkundër cikleve të dhunës, ekziston një përpjekje e vazhdueshme nga institucionet, shoqëria civile dhe qytetarët, për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe më të sigurt për të gjithë.

DHBGJ në Programet dhe Materialet e Fushatës së Partive Politike

Një masë e angazhimit të një shoqërie për të adresuar DhBGj është rëndësia e çështjes në agjendat e partive politike. Analiza e materialeve të fushatës zgjedhore të vitit 2025, duke përfshirë manifestet e partive, dokumentet zyrtare të programit dhe fjalimet e fushatës tregojnë se parandalimi dhe reagimi ndaj DhBGj morën pak vëmendje nga partitë kryesore politike në Shqipëri. Ky seksion gjurmon se çfarë (nëse ka) partitë premtuan ose përmendën në lidhje me DhBGj gjatë fushatës.

Partia në Qeveri - Partia Socialiste, e cila ishte në pushtet për tre mandate radhazi deri në vitin 2025, kryesisht kandidoi bazuar në historikun e saj qeverisë dhe planet e ardhshme ekonomike. Në programin e saj të publikuar dhe në tubimet e fushatës, referencat e qarta për dhunën me bazë gjinore ishin minimale. Platforma e PS-së e theksoi “fuqizimin e grave” si një vlerë - për shembull, duke u mburrur me përfaqësimin e grave në qeveri (në atë kohë, gratë mbanin gjysmën e pozicioneve ministrore, duke reflektuar progresin e arritur). Programi përmendi vazhdimin e Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore 2021- 2030 dhe mbështetjen për gratë sipërmarrëse. Megjithatë, për çështjen specifike të dhunës në familje ose seksuale, programi ofroi vetëm siguri të paqarta si “ne do të vazhdojmë të mbështesim masat kundër dhunës në familje” pa sqarime apo programe specifike. Nuk pati nisma të reja kryesore ose angazhime financimi të njoftuara për të forcuar reagimin ndaj dhunës në familje (siç janë strehimore të reja ose programe për autorët e krimit). Për shembull, fraza “ne do të vazhdojmë të mbështesim masat kundër dhunës në familje” u shfaq në një seksion të përgjithshëm, por pa sqarime mbi rritjen e buxhetit, zgjerimin e strehëzave ose reformat sistematike. Mbulimi i fushatës, si p.sh. “Rama: Të fokusohemi te ekonomia dhe barazia gjinore për punën”²⁹, theksoi punësimin dhe përfaqësimin, por e la dhunën në familje praktikisht të paprekur. Për më tepër, kandidatët e PS-së kryesisht nuk e ngritën çështjen e dhunës në familje përveç nëse u kërkohej. Kur një gazetar pyeti në një intervistë në lidhje me rritjen e numrit të vrasjeve të grave, një përfaqësues i PS-së mbrojti rezultatet e qeverisë duke vënë në dukje përmirësimet në kuadrin ligjor (p.sh., ndryshimet në ligjin për dhunën në familje) dhe ekzistencën e mekanizmave të referimit (PS përgjigjet për vrasjet në familje: Ligji ekziston, por duhet të funksionojë”³⁰, ku folësja mbrojti status quo-në pa premtuar veprime të reja dhe u largua nga tema kur u pyet. Kështu, partia në pushtet e trajtoi dhunën në familje si një çështje të zgjidhur

²⁹ Top Channel

³⁰ Newsbomb

sipas politikës ekzistuese, në vend të një prioriteti të fushatës që kërkon inovacion ose burime të mëtjeshme.

